



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 530/23 Data: 19/04/2023

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën një (1) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2024):
 1. *Menaxhment MSc, 120 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
 2. *Menaxhment BSc, 180 ECTS, me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i përcaktuar i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Menaxhment MSc 120 ECTS</i> , Riakreditim	Albana Berisha Qehaja Lura Rexhepi
2.	<i>Menaxhment BSc 180 ECTS</i> , Riakreditim	Liridon Veliu Blerim Dragusha Veton Zeqiraj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA me datë 21.02.2023 ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për të dy programet, me këtë përbërje: Magdalena Platis, Marko Komso.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Menaxhment MSc 120 ECTS*, Riakreditim, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht tre (3) standarde.
- Për programin e studimit *Menaxhment BSc 180 ECTS*, Riakreditim, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht tre (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 111 të mbajtur më 14.04.2023 ka shqyrtuar aplikacionin/kërkesën e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


 Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
 Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë